VENDIM

Data e miratimit: 17 gusht 2012

Lënda nr. 24/10

D. V.

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 17 gusht 2012, me anëtarët vijues të pranishëm,:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u paraqit më 23 mars 2010 dhe u regjistrua më 24 mars 2010.

2. Më 7 dhjetor 2011, Paneli kërkoi nga ankuesi të paraqesë informacione shtesë. Më 9 dhe 28 dhjetor 2011, Paneli pranoi dokumentacionin e kërkuar.

3. Më 27 shkurt 2012, Paneli kërkoi informacione nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP). AKP-ja u përgjigj me shkrim, më 29 shkurt 2012.

II. FAKTET

4. Ankuesi është ish banor i Kosovës, i cili aktualisht jeton në Serbi.

5. Ankuesi thekson se ai filloi të punojë në ndërmarrjen shoqërore "JPPK Belaçevac EPS" në vitin 1998, dhe se ai e humbi punën në shtator të vitit 1999. Ai nuk ka marrë kompensim për humbjen e pagave të tij.

6. Ai gjithashtu thekson se është pronar i pasurisë së paluajtshme që ndodhet në komunën e Lipjanit. Ankuesi e shfrytëzoi pronën deri në gusht të vitit 1999 kur për shkaqe sigurie ai u largua nga Kosova me familje.

7. Ankuesi më pas mësoi për faktin se një person i paidentifikuar e kishte uzurpuar pronën ndërmjet gushtit të vitit 1999 dhe prillit 2004.

8. Ankuesi parashtroi kërkesë pranë Drejtorisë për Çështje Banesore Pronësore (DÇBP). Më 27 qershor 2003, Komisioni i ankesave për çështje banesore pronësore i DÇBP-së urdhëroi që atij t'i jepet në posedim prona e kërkuar. Në shtator 2008, ankuesi kërkoi që prona e tij të merret nën administrimin e autoritetit administrativ të pasardhësit të DÇBP-së, Agjencia Kosovare e Pronës (AKP). Prona u mor nën administrimin e AKP-së më 17 nëntor 2008.

9. Nga informacionet e marra nga AKP-ja duket se ankuesi nuk ka nënshkruar dhe dorëzuar në AKP një formular për dhënien e pëlqimit në mënyrë që prona e tij të përfshihet në skemën e qiradhënies vullnetare.

III. ANKESA

10. Ankuesi ankohet për faktin se ai e humbi punën dhe se nuk ka marrë asnjë pagë që nga shtatori 1999. Në këtë aspekt ai thirret në shkelje të së drejtës së tij të garantuar me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

11. Ai po ashtu ankohet për faktin se nuk ka marrë fitime qiraje për pronën e tij. Në këtë aspekt ai mund të konsiderohet se thirret në shkelje të së drejtës së tij për gëzimin e papenguar të pronës, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

IV. LIGJI

12. Para se të shqyrtohet rasti për bazueshmërinë e tij Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë rastin, duke marrë parasysh kriteret për pranim të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

Ankesë lidhur me largimin *de facto* nga vendi i punës dhe humbja e fitimeve

13. Paneli përkujton se, sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai ka juridiksion vetëm për "ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut që ishin bërë jo më herët se 23 prill 2005, apo që dalin nga faktet e paraqitura para kësaj date kur faktet e tilla paraqesin shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut".

14. Paneli konsideron se largimi i ankuesit nga vendi i tij i punës ishte akt i atypëratyshëm që nuk paraqet ndonjë situatë të mundshme të vazhdimësisë (shih Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Jovanoviç*, nr. 59109/00, vendim i 28 shkurtit 2002; Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, *Novokmet*, nr. 51/10, vendim i 13 prillit 2011, §§ 5-8).

15. Paneli thekson se largimi nga puna kishte ndodhur më 1999. Nuk ishin zhvilluar procedura të tjera lidhur me këtë.

16. Për rrjedhojë, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit kohor të Panelit (*ratione temporis).*

Ankesa lidhur me mospagimin e qirasë

17. Ankuesi po ashtu ankohet për shkelje të së drejtës për të gëzuar pasurinë e tij si pasojë e mospagimit të qirasë për banesën e tij.

18. Sa i përket kësaj pjese të ankesës, duhet theksuar se pronari mund të marrë qira nga qiramarrësi që paguan qira, përmes AKP-së, kur pasuria e tij është vënë nën administrim të AKP-së dhe kur pronari është pajtuar që prona e tij të jetë e përfshirë në skemën e qiradhënies vullnetare.

19. Në këtë rast, nga informacionet e marra nga AKP-ja, rezulton se prona e ankuesit është vënë nën administrimin e AKP-së, por se ankuesi nuk e ka nënshkruar skemën e AKP-së për qiradhënie vullnetare. Për rrjedhojë, prona është e zbrazët dhe nuk gjeneron të ardhura.

20. Ankesa dhe informacionet e marra shtesë nuk paraqesin dëshmi, prandaj kjo mund të mbështesë konkludimin se është shkelur e drejta e ankuesit për mbrojtjen e pronës për shkak të dështimit të AKP-së që pronën ta japë me qira dhe ankuesit t'i paguaj shumat që duhej paguar.

21. Paneli konkludon se ankesa nuk zbulon ndonjë shkelje të së drejtës në të cilën thirret ankuesi. Prandaj, është i mendimit se kjo pjesë e ankesës duhet hedhur poshtë si e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

E SHPALL ANKESËN **TË PAPRANUESHME.**

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar